

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6570  
E hënë, 28 mars 2022  
çmimi 0.40

## DAÇIQI BËN THIRRJE PËR DHUNË, KUSH DUHET TË REAGOJË?

Shkruan: **Milazim KRASNIQI**



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KRYETARI I ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS, SAZAN IBRAHIMI, KA FOLUR PËR BASHKËPUNIMIN E KRYETARËVE TË KOMUNAVE ME QEVERINË

## KRYETARËT E KOMUNAVE, TË PAKËNAQUR ME BASHKËPUNIMIN ME NIVELIN QENDROR



Asociacioni i Komunave  
Asocijacija Kosovskih  
Association of Kosovo Mu

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, ka bërë me dije se kryetarët e komunave në çdo takim kanë theksuar bashkëpunimin jokorrekt me nivelin qendror. Ai ka treguar se ky shqetësim ka ardhur pasi janë ndërmarrë disa hapa për nivelin lokal pa konsulta paraprake me kryetarët e komunave. "Në veçanti duhet ta theksoj miratimin e ligjit për vetëqeverisje lokale apo amendamentin e këtij ligji nga qeveria, pa konsulta me kryetarët e komunave", ka deklaruar Ibrahim

## 32 ditë luftë. Zelensky, thirrje Perëndimit: Na ndihmoni me armë

FAQE 2



## KONJUFCA: DËSHMORËT GARANTOJNË THEMELE TË FORTA TË SHTETIT TONË

FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht -Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



#### 70 PËR QIND E KANDIDATËVE NUK E KANË KALUAR TESTIN PËR POLIC

F. 3

#### ZJARRE NË DISA KOMUNA, AGJENCIA E PYJEVE THOTË SE PO SHKAKTOHEN NGA DORA E NJERIUT

F. 6

#### KOSOVË - SHQIPËRI, VLERËSOHET I RËNDËSISHËM PROMOVIMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT DHE KULTURËS

F. 5

### EKONOMI



#### UKRAINA EKSPORTON DRITHËRAT E PARA ME TREN NË EVROPË

F. 7

#### USHQIMET NË SHQIPËRI, TVSH-NË MË TË LARTË NË EVROPË

F. 7

### SPORT



#### KOSOVA E ZHVILLON STËRVITJEN E FUNDIT, FAZLIJI E VLERËSON SPECIALE MIQËSOREN ME ZVICRËN

F. 10



# 32 ditë luftë. Zelensky, thirrje Perëndimit: Na ndihmoni me armë

KIEV, 27 MARS - E diela ka shënuar ditën e 32-të të luftës në Ukrainë, ndërsa situata sa vjen dhe bëhet edhe më e vështirë.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky i ka kërkuar Perëndimit t'i rrisë furnizimet ushtarake për vendin e tij. Ai ka thënë se nuk ishte vetëm Ukraina në rrezik dhe vetëm një për qind e tankeve dhe avionëve të NATO-s nevojiten për t'i ndihmuar forcat e tij ta luftojnë Rusinë.

Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike (IAEA) ka njoftuar se ishte e shqetësuar për presionet me të cilat po përballet stafi i termocentralit të Çernobilit, pasi nuk ka pasur asnjë rotacion të stafit për gati një javë.

Më shumë se 3.7 milionë njerëz janë larguar nga Ukraina.

Ukraina dhe Rusia kanë rënë dakord për dy korridore humanitare për t'i evakuuar civilët, duke përfshirë edhe ukrainasit që largohen me makina private nga qyteti i rrethuar i Mariupolit.

Ukraina ka zbrapsur shtatë sulme në rajonet lindore të Donetskut dhe Luhanskut, sipas forcave të armatosura të vendit.

Ukraina ka thënë se Rusia ka filluar t'i shkatërronë depot e karburantit dhe ushqimit. Qyteti Chernihiv ka 44 persona të plagosur rëndë, duke përfshirë tre fëmijë, të cilët nuk mund të evakoheshin për t'u trajtuar.

Shpërthime të fuqishme janë dëgjuar në Lviv, qyteti në perëndim të Ukrainës, jo shumë larg kufirit polak dhe kryetari i qytetit ka thënë se ai



mendon se sulmet ajrore ruse kishin për qëllim t'i dërgonin një mesazh Bidenit. Lviv është bërë një strehë e sigurt për ukrainasit që ikin nga konflikti. "Për hir të Zotit, ky njeri nuk mund të qëndrojë në pushtet", ka thënë presidenti amerikan Joe Biden për homologun e tij rus Vladimir Putin gjatë një fjalimi në kryeqytetin e Polonisë, Varshavë. Ndërsa Kremli ka thënë se nuk i takon Bidenit të vendosë se kush e qeveris Rusinë.

Dy korridore humanitare për evakuimin e civilëve janë hapur të dielën të Ukrainë, ka njoftuar zëvendëskryeministrja e Ukrainës, Iryna Vereshchuk, përfshirë edhe atë nga Mariupol.

Paralelisht me sulmet dhe

bombardimet në Ukrainë, Rusia është duke zhvilluar edhe një proces negociatash me Kievin - me sa thuhet, për t'i dhënë fund luftës që ka nisur vetë. Raundi i parë i bisedimeve është mbajtur më 28 shkurt, katër ditë pasi shteti rus ka nisur pushtimin e paprovokuar të fqinjët të tij.

## Qyteti Çernihiv i Ukrainës mbetet pa ujë, ngrohje dhe rrymë

Shkatërrimi i gjerë ka lënë popullsinë e Çernihivit pa ujë, ngrohje ose energji elektrike, derisa trupat ruse vazhdojnë ta rrethojnë qytetin verior të Ukrainës.

Furnizimi me gaz ishte ende

pjesërisht funksional, sipas administratës rajonale të dielën. Infrastruktura e qytetit është shkatërruar nga "luftimet aktive", por po bëhen përpjekje për t'i riparuar dëmet, ka shkruar në "Telegram" shefi i administratës, Viacheslav Chau.

Trupat ruse kanë rrethuar qytetin verior prej disa kohësh. Një rrugë kyçe nga qyteti, e vendosur pranë kufijve rusë dhe të Bjellorusisë, të çon në Kiev. Kryebashkiaku Vladyslav Atroshenko ka thënë se qyteti ishte "plotësisht i shkatërruar" nga trupat ruse në komentet e së shtunës. Ai ka njoftuar se më shumë se 200 civilë janë vrarë javët e fundit dhe se më shumë se gjysma e 285 000 banorëve fillestarë të qytetit janë larguar.

## Oligarkët e Rosisë mund të bëjnë biznes në Turqi

Oligarkët e Rosisë mund të vazhdojnë të bëjnë biznes në Turqi për sa kohë që ata respektojnë ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar, ka thënë ministri i Jashtëm i Turqisë, Mevlut Cavusoglu.

I intervistuar në margjinat e Forumit të Dohas në Katar, Cavusoglu u pyet nëse oligarkët rusë që përballen me sanksione nga vendet perëndimore mund të bëjnë biznes në Turqi. "Sigurisht, nëse është e ligjshme, nëse nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Nëse është kundër ligjit ndërkombëtar, kjo është një



histori tjetër", theksoi Cavusoglu. Dy superjahte që i përkasin miliardit rus Roman Abramovich u ankoruan në Turqi

këtë javë. I pyetur për statusin e tyre, ministri tha se Turqia zbatoi sanksionet e miratuara nga Organizata e Kombeve të

Bashkuara.

Shtetet e Bashkuara dhe vendet anëtare të BE-së kanë vendosur masa të rrepta kundër Rosisë lidhur me pushtimin e Ukrainës. Masat përfshijnë vendosjen e oligarkëve dhe individëve të tjerë të afërt me Putinin në listat e sanksioneve.

Disa vende kanë ndaluar jahte në pronësi të më të pasurve të Rosisë.

Roman Abramovich, miliarderi rus, është goditur me një ngrirje të aseteve në Mbretërinë e Bashkuar dhe ndalim udhëtimi. Por Turqia, anëtare e NATO-s, e cila ka lidhje

të forta me Rusinë dhe Ukrainën, nuk i është bashkuar regjimit të sanksioneve perëndimore ndaj Moskës.

I vënë nën presion nga pyetja nëse oligarkët rusë mund të bëjnë biznes në Turqi, Cavusoglu u përgjigj: "Ne do të lejojmë çdo aktivitet të ligjshëm dhe legjitim dhe nuk do të lejojmë asnjë veprimtari të paligjshme në Turqi".

Turqia e ka përkrahur pushtimin rus të Ukrainës "të papranueshëm" dhe ka ofruar shërbimet e saj si ndërmjetëse për të ndihmuar në përfundimin e luftës.



# Konjufca: Dëshmorët garantojnë themele të forta të shtetit tonë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

**OBILIQ, 27 MARS** - Për ta nderuar sakrificën për liri të anëtarëve të familjes Rama nga fshati Shkabaj i Obiliqit, kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka bërë të dielën homazhe dhe ka vendosur lule para lapidarit të të rënëve të kësaj familjeje. Kryetari Konjufca para të pranishmëve ka thënë se dëshmorët dhe të gjithë ata

të cilët kontribuuan për liri garantojnë themele të forta të shtetit tonë. Ai ka thënë se rënia e familjes Rama, këtu e 23 vjet më parë, është vazhdimësi e sakrificës së familjes Jashari. "Jemi mbledhur ta kujtojmë rënien e lavdishme të familjes Rama. Kjo sakrificë është më e larta për atdhe që njeriu mund ta mendojë. Burra e gra kanë luftuar për lirinë e fëmijëve tanë dhe të brezave të ardhshëm. Shembulli i familjes Rama na dëshmon

se kurdo që atdheu është në rrezik nuk kursehet asgjë, madje as vetë jeta", ka theksuar kryetari Konjufca. Në këtë aktivitet përkujtimor ishin të pranishëm edhe deputetë të Kuvendit, kryetari i komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, familjarë dhe bashkëluftëtarë të të rënëve, si dhe qytetarë të tjerë. Më 27 mars të vitit 1999 forcat pushtuese serbe vranë 10 anëtarë të familjes Rama nga fshati Shkabaj i Obiliqit.



## 70 për qind e kandidatëve nuk e kanë kaluar testin për polic



**PRISHTINË, 27 MARS** - Policia e Kosovës ka shpallur listën e rezultateve të testit me shkrim të kandidatëve për zyrtarë policorë por, krahasuar me numrin e atyre që u janë nënshtruar testit online, janë pak ata që e kaluan. Policia e Kosovës për herë të parë ka aplikuar metodën online të testimit të kandidatëve për zyrtarë policorë. Nga gjithsej rreth 11 000 të rinj sa kishin aplikuar, vetëm 1 447 persona e kanë kaluar fazën e parë me shkrim.

E fajtorë për krejt këtë rezultat po thuhet se është testimi online. Kryetari i Komisionit për Siguri, Bekë Berisha, tha se do t'i propozojë qeverisë që ta përsërisë edhe një rekrutim. "Për të dështuar si proces është problem sepse ata që kanë fituar në këtë proces, kanë mundësi të ankohen, pra nuk mund të shkojmë ashtu. T'i ulim kriteret nuk bën ligjërisht. E vetmja formë është, dhe do t'i kisha propozuar qeverisë, që të përsëritë edhe një rekrutim dhe

testimi të mos bëhet më në formë kompjuterike, sepse ka dështuar ai sistem, ka rënë shpeshherë, edhe pyetjet janë më të lehta për kandidatët", ka thënë Berisha për KP. Ai ka shtuar se ka pranuar ankesa të shumta pavarësisht se ky është testi i parë, ndërsa problemi se pse ky po cilësohet si testi më i dështuar që nga themelimi i këtij institucioni të sigurisë, po del të jenë problemet me sistemin kompjuterik dhe se ka pasur pyetje të vështira.

## Kosova kërkon thellimin e bashkëpunimit diplomatik, ekonomik dhe tregtar me Katarin

**PRISHTINË, 27 MARS** - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, ka takuar Emirin e Shtetit të Katarit, Sheikh Tamim bin Hamad Al Thani, gjatë vizitës zyrtare në Doha. Presidentja Osmani ka falënderuar Emirin për marrëdhëniet e shkëlqyera në mes të dy vendeve tona dhe ka shprehur gatishmërinë për ta thelluar bashkëpunimin diplomatik, ekonomik dhe tregtar. Veç kësaj, presidentja e ka informuar Emirin për përparimin e gjithmbarshëm në

Kosovë, duke përfshirë sektorët e bujqësisë, turizmit dhe infrastrukturës si fusha potenciale për investim nga Shteti i Katarit. Presidentja Osmani ka përmendur ndihmën e popullit dhe Shtetit të Katarit ndaj Kosovës përgjatë ditëve më të errëta për popullin tonë si dhe pas shpalljes së pavarësisë. "Populli i Kosovës nuk do ta harrojë asnjëherë zemërgjersinë e shtetit të Katarit në momente të vështira e deri më sot. Ne mbesim të

përkushtuar që t'i thellojmë raportet ndërshtetërore" ka thënë presidentja. Presidentja Osmani po qëndron në Doha të Katarit, në edicionin e njëzetë të Forumit të Dohas i cili ka mbledhur liderë botërorë, politikanë, studiues dhe përfaqësues të shoqërisë civile për të diskutuar për hapat përpara pas zhvillimeve të shkaktuara nga pandemia në të gjitha aspektet e jetës dhe zhvillimeve të fundit gjeopolitike, përfshirë luftën në Ukrainë.



## Hyn në fuqi vendimi i Gjermanisë për njohjen e patentëshoferëve të Kosovës



**PRISHTINË, 27 MARS** - Gjermania lejon konvertimin e patentëshoferëve nga Shqipëria e Kosova duke nisur nga dita e diel. Këtë e tutje konvertimi i patentave të Shqipërisë dhe Kosovës në Gjermani do të bëhet pa provime shtesë. Këtë kërkesë e miratoi në Berlin

Këshilli Federal i Gjermanisë me kërkesë të qeverisë federale. "Për fat të mirë ua hoqëm edhe këtë pengesë!", tha Winfried Herrmann, ministër i Transporteve të Landit Baden Württemberg, në cilësinë e tij si kryetar i Konferencës së Ministrave

të Transportit, teksa po fliste për njohjen e patentave nga Shqipëria dhe Kosova, të premtën në Bundesrat. Rregullorja e re vlen vetëm për personat që kanë një vendbanim të rregullt në Gjermani dhe që e kanë marrë patentën përpara se të vinin këtu.





KRYETARI I ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS, SAZAN IBRAHIMI, KA FOLUR PËR BASHKËPUNIMIN ME KRYETARËT E KOMUNAVE DHE QEVERINË

# Kryetarët e komunave, të pakënaqur me bashkëpunimin me nivelin qendror

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, ka bërë me dije se kryetarët e komunave në çdo takim kanë theksuar bashkëpunimin jokorrekt me nivelin qendror. Ai ka shtuar se ky shqetësim ka ardhur pasi janë ndërmarrë disa hapa për nivelin lokal pa konsulta paraprake me kryetarët e komunave. “Në veçanti duhet ta theksoj miratimin e ligjit për vetëqeverisje lokale apo amendamentin e këtij ligji nga qeveria, pa konsulta me kryetarët e komunave”, ka deklaruar Ibrahim.

**PRISHTINË, 27 MARS** - Asociacioni i Komunave të Kosovës ka shprehur shqetësim për mosbashkëpunimin në mes të komunave dhe nivelit qendror mbi hartimin e politikave që prekin kompetencat e nivelit lokal, por edhe sa i përket buxhetit. Ai ka potencuar edhe qeverisjen njëvjeçare të kryeministrit duke e cilësuar bashkëpunim jokorrekt. Kreu i AKK-së, Sazan Ibrahim, ka folur mbi problemet e komunave lidhur me bashkëpunimin me qeverinë. Ai ka përmendur rregullimin e kontratave kolektive pasi që vazhdojnë të paguhen nga buxheti komunal. “Komunat e Republikës së Kosovës në takimet që ne si Asociacioni i

Komunave kemi pasur edhe në kontaktet e përditshme, kanë shprehur shqetësim sa i përket bashkëpunimit me nivelin qendror për hartimin e politikave që prekin kompetencat e nivelit lokal por, gjithashtu, sa i përket buxhetit. Problemet kryesore që komunat i kanë theksuar në takimet tona janë rregullimi i kontratave kolektive, sepse ende kontratat kolektive vazhdojnë të paguhen nga buxheti komunal, kurse ato janë lidhur nga niveli qendror me sindikatat e shëndetësisë, përkatësisht të arsimit. Problem, gjithashtu i identifikuar, është edhe mospjesëmarrja e tyre në draftimin apo amendamentin

e ligjeve për vetëqeverisje lokale, i cili ka qenë bazik për funksionimin në pushtet lokal. Ka problem edhe sa i përket hartimit të ligjit për financa lokale, por ky ligj është draftuar që disa vjet, por ende nuk është miratuar nga Qeveria e Kosovës në mënyrë që të kalojë edhe në Kuvendin e Kosovës”, ka thënë Ibrahim për “Kosovapress”. Ndërsa sa i përket ligjit për financa lokale, Ibrahim thotë se problem kryesor është granti i katërt, pasi që edhe komunat kërkojnë që ky grant të funksionalizohet. Ai shton se si asociacion kanë dërguar edhe porosi në ekzekutiv se nuk duhet t’i injorojë komunat për hartimin e

politikave. “Sa i përket ligji për financa lokale, problemi kryesor është granti i katërt. Komunat kërkojnë që ky grant të funksionalizohet sa më shpejt që është e mundur. Shqetësim tjetër i kryetarëve të komunave është edhe mosfunksionalizimi i bordit të organit shqyrtues të prokurimit publik. Ende ky bord nuk është funksional dhe ende komunat apo qytetarët nuk përfitojnë drejtpërdrejt nga implementimi i shumë projekteve të cilat qëllim kanë përmirësimin e jetës së qytetarëve. Ne si Asociacioni i Komunave të Kosovës kemi dërguar një porosi në nivelin qendror se Qeveria e Kosovës nuk duhet t’i injorojë komunat e Kosovës për hartimin e politikave të cilat prekin kompetencat e komunave, gjithashtu edhe sa iu përket buxheteve që ndahen për nivelin lokal”, ka theksuar Ibrahim. Kreu i AAK-së ka folur edhe mbi punën njëvjeçare të qeverisë Kurti, duke e cilësuar bashkëpunim jokorrekt. “Ne

jemi një mekanizëm që i mbron interesat e autoriteteve lokale përballë nivelit qendror. Kryetarët e komunave në çdo takim kanë theksuar bashkëpunimin jokorrekt me nivelin qendror, pasi që janë ndërmarrë disa hapa me nivelin lokal pa konsulta paraprake me kryetarët e komunave. Në veçanti duhet ta theksoj miratimin e ligjit për vetëqeverisje lokale apo amendamentin e këtij ligji nga qeveria, pa konsulta me kryetarët e komunave. Gjithashtu, mosfunksionalizimi i bordit të OBSH-së ka impakt të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarit. Së këndejmi, kontratat kolektive komunat ende vazhdojnë t’i paguajnë nga buxhetet e tyre vetjake e jo nga niveli qendror, por ka edhe shumë dilema të tjera që kryetarët e komunave dëshirojnë t’i zgjedhin me nivelin qendror, por për shkak të këtij mosbashkëpunimi jokorrekt dhe jo të sinqertë kemi shumë probleme edhe në zbatimin e shumë projekteve”, ka pohuar Ibrahim.



# DAÇIQI BËN THIRRJE PËR DHUNË, KUSH DUHET TË REAGOJË?

Konsulli austro-hungarez në Shkup raportonte se me të hyrë në Prishtinë, më 22 tetor 1912, forcat ushtarake serbe kishin ekzekutuar pesë mijë shqiptarë. (Shih: Srbija i Albanci, Çasopis za kritiko znanosti, Ljubljana, 1989)



Milazim KRASNIQI

Ivica Daçiçi jep shpesh dëshmi se është nxënës përsëritës i shkollës kriminale të Millosheviqit. E fundit është një deklaratë në fushatën parazgjedhore, ku tha se do të propozojë që data 22 tetor (e vitit 1912) të kremtohet si "Dita i Fitores në Kosovë." Daçiçi ka deklaruar kështu:

"Na duhet ajo ditë që ta dinë të gjithë se do të vijë fitorja e re serbe". Pra, programi i tij dhe i partisë së tij SPS, është hakmarrja e re në Kosovë, në pajtim me sloganin gjenocidal, "osvetiti Kosovo". Ndërsa, e vërteta historike për 22 tetorin 1912 është si vijon: Serbia nën pretekstin e luftës kundër Shtetit Osman, ka kryer gjenocid kundër kombit shqiptar në Kosovë. Për këtë ka dëshmi të shumta të kohës, Fjala vjen, konsulli austro-hungarez në Shkup raportonte se me të hyrë në Prishtinë, më 22 tetor 1912, forcat ushtarake serbe kishin ekzekutuar pesë mijë shqiptarë. (Shih: Srbija i

Albanci, Çasopis za kritiko znanosti, Ljubljana, 1989) Ndërsa gazetari amerikan i gazetës "New York Times", Piktall, si dëshmitar okular, ka lënë këtë dëshmi: "Masakrat që bënë serbët në Kosovë, nën Kryqn' e Krishterë, kapërcejnë çdo instikt gjakpirësije." Nga ana tjetër, historiani/demografi amerikan, Xhastin McCarthy, ka nxjerrë shifrat e viktimave shqiptare në luftën ballkanike, sipas të cilave 27% e shqiptarëve janë vrarë ndërsa 35% janë dëbuar nga vendi, pra 62% janë vrarë/çrrënjësuar nga vatrat e veta. Zhduka e çrrënjësja e 62% të një

popullsie është gjenocid. Atë ditë të gjenocidit në Luftën e Parë Ballkanike kërkon ta festojë Daçiçi. Baba i tij ideologjik, Millosheviqi, më 27 qersor 1989 në Gazimestan pat paralajmëruar lufërat gjenocidale të Serbisë me këto fjalë: "Gjashtë shekuj më vonë (nga Beteja e Kosovës e vitit 1389, vërejtje e autorit), ende jemi në beteja dhe para betejave. Ato nuk janë të armatosura, edhe pse as ato ende nuk janë të përjashtuara". Tash Daçiçi po paralajmëron luftëra e hakmarrje të reja, në frymën e Millosheviqit. Për këtë arsye mendoj se institucionet tona

të drejtësisë duhet të ngrisin padi kundër Daçiçit për këtë deklaratë, e cila minimalisht është thirrje për dhunë dhe thirrje për hakmarrje. Në këtë konstket, do të duhej të ndihej gjallë edhe Edi Rama, si aleat i Daçiçit në kuadër të projektit serbomadhi, "Ballkani i Hapur", Pse? Sepse nëse e zyrtarizon Daçiçi si kryeministër (në cilësinë e kandidatit për kryeministër e ka paraqitur atë pikë të programit të vet qeverisës) atë datë si festë kombëtare e shtetërore të Serbisë, duhet ta dimë a do ta festojnë të gjitha shtetet anëtare të "Ballkanit të Hapur."

## Kosovë - Shqipëri, vlerësohet i rëndësishëm promovimi i zhvillimit ekonomik, turizmit dhe kulturës

EPOKA  
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 MARS - Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Liza Gashi, ka zhvilluar një takim virtual me zëvendësministren për Evropë dhe Punë të Jashtme të Shqipërisë, Artemis Malo.

Gashi është shprehur e lumtur që komunikimi dhe bashkëpunimi konkret mes dy ministrive shqiptare është shtuar dukshëm si dhe ka shprehur gatishmërinë që ta vazhdojnë punën për implementimin e disa marrëveshjeve. "Marrëveshjet në fushën e diasporës midis dy shteteve kanë shërbyer si një hap cilësor në këtë drejtim. Së fundmi është rritur angazhimi për implementimin e marrëveshjeve të nënshkruara dhe realizimi i synimeve afatgjata të Deklaratës për



Bashkëpunim dhe Partneritet Strategjik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, por se duhet të jemi edhe me të përkushtuar për ta adresuar potencialin e

mërgatës", është shprehur zëvendësministrja Gashi. Duke përmendur fillimin e dialogut me mërgatën, që ministrja Gërvalla dhe zëvendësministrja Gashi e kanë

realizuar tashmë në disa qendra në Evropë, Gashi me theks të veçantë ka nënvizuar përgatitjen e një plani të veprimit të përbashkët, që do ta përfshinte edhe organizimin e

përbashkët të Ditëve të Kulturës Shqiptare në diasporë. "Promovimi i zhvillimit ekonomik, turizmit, kulturës dhe produkteve vendore është shumë i rëndësishëm që të bëhet bashkërisht nga të dy ministrinë", është shprehur Gashi.

Zëvendësministrja Malo është shprehur e gatshme për bashkëpunim dhe për hapa konkretë në mënyrë që sidomos diaspora shqiptare të bashkohet.

Gashi duke u zotuar për një bashkëpunim në të mirë të mërgatës shqiptare nëpër botë, ka informuar Malon edhe për krijimin e departamentit të veçantë për diasporën brenda ministrisë, si dhe programin e followship që do të nisë shpejt të zbatohet e që u mundëson të rinjve nga diaspora të angazhohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

## 37 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 27 MARS - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, pas 1 325 testimeve, 37 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk

është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të dielën janë shëruar edhe 32 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 223 572. Në total numri i rasteve aktive është 659.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 98 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 821 247 doza të vaksinës. Deri më sot 820 011 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Deri më sot janë dhënë 99 780 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.





## Ministri Mehaj i quan "ujqër" kadetët e FSK-së

PRISHTINË, 27 MARS - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, i ka quajtur kadetët e FSK-së "ujqër", teksa ka thënë se ata janë të pandalshëm, të pathyeshëm dhe të pamposhtur. "Ujqërit tanë të rinj janë të pandalshëm, të pathyeshëm dhe të pamposhtur. Se kadetët tanë janë të tillë, këtë e dëshmuam edhe në Stërvitjen 'Guximi i

palëkundur 2022'. Jeta për ujqërit tanë nuk është e lehtë, por ata janë këmbëngulës dhe, mbi të gjitha, kanë besim te vetja dhe besimi në ekip", ka thënë Mehaj në një njoftim në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se këta kadetë të FSK-së janë të talentuar dhe të vetëdijshëm për misionin e tyre sfidues, por

janë të vendosur se objektivi i synuar duhet të arrihet. "Ata e dinë se çelësi më i rëndësishëm i suksesit është vetëbesimi, e çelësi më i rëndësishëm për vetëbesimin është përgatitja. E ardhmja jeni ju, prandaj jemi krenarë me ju. Vazhdojmë të përgatitur maksimalisht drejt sukseseve maksimale", ka shkruar Mehaj.



## Motra e dëshmorit dhe kushërira e Ukshin Hotit e vë në siklet Kurtin, i kërkon sqarim se pse e shkarkuan si diplomate

**EPOKA E RE** FATON DËRMAKU

RAHOVEC, 27 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në 23-vjetorin e masakrës në Krushë të Madhe, derisa po bënte homazhe bashkë me kryeparlamentarin Glauk Konjufca te varrezat e martirëve, është përballur me një situatë jo të këndshme.

Motra e një dëshmori, Bahrije Hoti, e cila ka thënë se është kushërira e veprimtarit Ukshin



Hoti, i ka dalë përpara kryeministrit Kurti dhe ka kërkuar nga ai të dijë se pse para disa ditësh është shkarkua nga detyra e saj si shefe e konsullatës së Republikës së Kosovës në Bern. "Më vjen mirë që keni ardhur sot. Por, si është e mundur që unë para një jave jam pushuar nga puna si diplomate e Kosovës, duke dalë nga ky gjak? Sakrifika e këtyre dëshmorëve më ka dërguar të shkollohem në Austri dhe unë sot me padrejtësinë më të madhe, para një jave

shkarkohem nga puna si diplomate", i ka thënë ajo Kurtit. I gjendur në situatë të palakmueshme, kryeministri Kurti i është zotuar se do të interesohet për shkarkimin e saj. "Do të interesohem për çka bëhet fjalë", i ka thënë Kurti.

Ajo sërish ka insistuar duke i treguar Kurtit se ka pasur padrejtësi gjatë shkarkimit të diplomatëve. "E kuptoj, por padrejtësitë po vazhdojnë, me të thënë të drejtën", ka thënë ajo. Ministria e Punëve të Jashtme

dhe e Diasporës (MPJD) ditë më parë ua ka ndërprerë marrëdhënien e punës 11 punonjësve të kësaj ministrie të cilit ishin anëtarë të shërbimit të jashtëm.

Në njoftimin e MPJD-së thuhet se 11 punonjësve u është ndërprerë marrëdhënia e punës pas një analize të hollësishme ligjore.

Në mesin e atyre që u është ndërprerë marrëdhënia e punës është edhe Bahrije Hoti, e cila ka qenë shefe e konsullatës së Republikës së Kosovës në Bern.

## Zjarre në disa komuna, Agjencia e Pyjeve thotë se po shkaktohen nga dora e njeriut

PRISHTINË, 27 MARS - Edhe pse nuk jemi në stinën e verës, gjatë dy ditëve disa prej pyjeve në Kosovë janë kapluar nga flakët.

Policia e Kosovës ka njoftuar për raste të përfshirjes së disa prej pyjeve nga zjarri, ku për të njëjtat kishin intervenuar zjarrfikësit dhe vetë banorët për t'i vënë nën kontroll flakët.

Zëvendëskryeshefi i Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, Bekim Hoxha, ka konfirmuar për "Telegraf"-in se këto zjarre dyshohet se shkaktohen nga dora e njeriut. "Në këto kohë faktori njeri është ai që po i shkakton këto zjarre. Nuk mund të presim që po



ndodhin vetë ato", ka deklaruar ai, duke shtuar se pyjet po përfshihen nga zjarri për arsye se njerëzit po i djegin livadhet dhe

pastaj zjarri po shpërndahet. "Kjo po ndodh sepse njerëzit po i djegin disa livadhe apo ara, pastaj po shpërndahet zjarri", ka

thënë Hoxha.

Ndërkaq, sipas Policisë së Kosovës, 50 hektarë pyje në Novobërdë ishin përfshirë nga flakët, një pjesë e pyjeve në Ranilluk dhe në Rahovec. "Raportohet se në rrethana të panjohura është përfshirë nga zjarri një sipërfaqe e pyllit prej 10-hektarësh, pronë e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës. Njësitë relevante policore kanë dalë në vendin e ngjarjes. Po ashtu, në vendin e ngjarjes kanë dalë edhe eksperti i zjarrit dhe zjarrfikësit të cilët e kanë lokalizuar dhe shuar zjarrin. Në lidhje me rastin është konsultuar prokurori i shtetit",

thuhet në raportin 24-orësh të policisë.

Gjithashtu, sipas këtij raporti, janë përfshirë nga zjarri rreth 50 hektarë pyll, pronë private dhe shtetërore. "Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitet përkatëse, ndërsa ekipi i zjarrfikësve ka lokalizuar zjarrin. Nuk raportohet për të lënduar. Ankuesi mashkull kosovar ka raportuar se është përfshirë nga zjarri një pjesë e pyjeve, të cilin së bashku me qytetarë të tjerë e kanë shuar. Në lidhje me rastin është konsultuar prokurori i shtetit", ka njoftuar Policia e Kosovës.

## Temperaturat gjatë kësaj jave deri në 20 gradë

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 MARS - Ditët e fundit të këtij muaji do të shoqërohen me mot të ngrohtë. Siç njofton Prishtina Weather, ditët e para të javës së fundit të muajit mars do të ketë vranësira dhe diell.

Nga e enjtja priten edhe të reshura shiu. "Ditëve të fundit të muajit mars situata sinoptike gradualisht do të fillojë të ndryshojë, megjithëse në aspektin termik po mbetet ngrohtë. Ditëve të para do të ketë edhe vranësira që kalojnë mbi


vend, e ku përreth viseve malore edhe mund të sjellin edhe riga lokale shiu, apo edhe bore në zona më të larta. Nga dita e enjte parashihen edhe të reshura shiu, kryesisht të karakterit lokal, më të theksuara në viset malore në perëndim të vendit. Ditën e premte reshjet do të jenë më të shpërndara e të shoqëruara edhe me bubullima", thuhet në njoftimin e Prishtina Weather. Indeksi i cilësisë së ajrit në një pjesë të stacioneve do të kalojë edhe në vlera të pranueshme apo edhe mesatare. Nga dita e mërkurë mbi rajon edhe pritet të

depërtojnë koncentrimet e pluhurit saharian, që veçse shtyjnë indeksin në vlera të dobëta edhe gjatë ditës.

Temperaturat mbesin të larta, me minimale që luhaten ndërmjet 2C e 8C, e ato maksimale luhaten ndërmjet 15C e 18C, e lokalisht edhe kapin vlera deri në 20C.

Era ndryshon drejtimin dhe frynë nga jugperëndimi mesatare 3-8m/s, e nga dita e mërkurë mesatarisht e fuqishme deri në 13m/s.

Shtypja atmosferike më në fund pëson rënie të theksuar, tashmë edhe nën vlera mesatare.





# Ukraina eksporton drithërat e para me tren në Evropë

KIEV, 27 MARS - Tregtarët kanë eksportuar furnizimet e para të misrit ukrainas në Evropë me tren pasi portet detare të vendit mbeten të bllokuara për shkak të pushtimit rus, tha të dielën konsulencia bujqësore (APK Inform).

Ukraina është prodhuese dhe eksportuese kryesore në botë e drithërave dhe pothuajse të gjitha eksportet e saj janë transportuar tradicionalisht nga portet e saj të Detit të Zi. Eksportet mujore të drithërave i kalonin 5 milionë tonë para luftës.

Tregtarët dhe zyrtarët e bujqësisë kanë thënë se Ukraina, e cila ende ka vëllime të konsiderueshme të drithit në magazinë, mund të fillojë të eksportojë me tren përmes kufirit të saj perëndimor. "Grupet

e para prej disa mijëra tonësh misër tashmë janë eksportuar përtej kufirit tokësor perëndimor të Ukrainës. Vështirësitë me logjistikën vazhdojnë, oferta ende mbizotëron mbi kërkesën, por çmimet kanë pushuar së rëni", ka njoftuar APK-Inform në një raport.

APK-Inform ka njoftuar se çmimet e misrit ukrainas për blerësit nga Polonia dhe shtetet baltike ishin 250 deri në 265 dollarë për ton dhe 275 dollarë për ton për Sllovakinë.

Autoritetet ukrainase të transportit kanë thënë se deri në 600 000 tonë drithë në muaj mund të eksportohen me trena nga Ukraina në Evropë.

Javën e kaluar eksportet e grurit të Ukrainës arritën në 44 milionë tonë në sezonin 2021/22 korrik-qershor.



# Ushqimet në Shqipëri, TVSh-në më të lartë në Evropë



TIRANË, 27 MARS - Shtrenjtimi i produkteve bazë ka nxitur qeveritë e disa vendeve ta heqin Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSh-në) për ushqimet ose ta zbrisin nivelin e saj. Por, nga Qeveria në Shqipëri nuk ka një vendim të tillë edhe pse vendi ka përqindje të lartë të këtij tatimi për ushqime në Evropë dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor. Pas nisjes së luftës në Ukrainë, e cila po shkakton rritje të shpejtë të çmimeve të karburanteve dhe mallrave të konsumit, qeveritë e disa vendeve reagojnë me një paketë masash ku përfshihen edhe zbritja e nivelit të TVSh-së ose heqja e saj për produktet bazë.

Disa aplikuan norma të shkurtuara të TVSh-së që pas pandemisë Covid-19, por nga qeveria shqiptare nuk është ndërmarrë asnjë masë në këtë

drejtim, edhe pse është kërkuar vazhdimisht nga opozita.

Ndërkohë, Maqedonia e Veriut vendosi heqjen e TVSh-së për produktet bazë, uljen e akcizës dhe TVSh-së për karburantet.

Kosova vendosi një marzhe fitimi për kompanitë dhe çmim tavan për karburantet, ndërsa Kroacia reduktoi nivelin e TVSh-së dhe hoqi akcizën për karburantet.

Të njëjtat masa mori edhe qeveria serbe. Por, përtej krizës, shtetet aplikojnë në mënyrë konstante apo të përkohshme edhe tatim në masë të shkurtuar për grupin e mallrave ushqimore. Shqipëria është nga pak vende që nuk e aplikojnë.

Duke mos reduktuar tarifën për ushqimet, Shqipëria klasifikohet në vendet me përqindjen të lartë të TVSh-së për ushqime në Evropë dhe rajonin e Ballkanit.

Ndërkohe, në një faturë të

publikuar nga deputeti i Partisë Socialiste, Taulant Balla, shihet se kostoja e disa produkteve bazë pa TVSh është rreth 1 000 lekë [8.20 euro], kësaj shume i shtohet dhe TVSh-ja për çdo produkt duke e rënduar xhepin e konsumatorëve me mbi 200 lekë më shumë.

Për produktet ushqimore norma mesatare e TVSh-së që aplikohet në vendet e BE-së dhe Ballkanit Perëndimor rezultojnë 9 për qind, ndërkohë që në Shqipëri mallrat e konsumit të përditshëm taten 20 për qind. Referuar të dhënave të platformës PëC, në artikujt bazë Serbia aplikon TVSh-në prej 10-përqindësh, Kosova 8 për qind, Mali i Zi 7 për qind, Maqedonia e Veriut 5 për qind.

Edhe Bosnja e Hercegovina, që nuk aplikon normë të shkurtuar, ka një barrë fiskale më të ulët, pasi norma standarde është 17 për qind.

## Para të falsifikuara, brenda tre muajve mijëra euro të raportuara

PRISHTINË, 27 MARS - Rastet e falsifikimit të parave janë raportuar edhe më shumë ditët e fundit në Kosovë, më së shumti hasen kartëmonedha 100 euro dhe monedha 2 euro. Deri tash janë me mijëra raste të lajmëruara në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë. Drejtori i Departamentit për Traseologji në AKF, Milazim Tahirukaj, tha se ditët e fundit kanë pranuar raportime të shumta të parave

të falsifikuara. Ai ka thënë kartëmonedha më e falsifikuar është ajo prej 100 eurosh, ndërsa prej monedhave është 2 euro. "Në bazë të statistikave dhe krahasimeve mes kësaj periudhe dhe periudhës së vitit kaluar, e kemi edhe këtë vit sikurse vitin e kaluar, kartëmonedhën 100 euro, e cila është më e falsifikuar sa i përket kartëmonedhave, ndërsa sa i përket

monedhave që janë me mijëra monedha të falsifikuara, e kemi monedhën 2 euro. Deri tani të lajmëruara qindra raste por, në fakt, te sasia apo numri i dëshmimeve është me mijëra raste të lajmëruara në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë. Sipas përshkrimit i cili bëhet nga policia, ato vijnë prej vendeve të ndryshme, prej marketeve të ndryshme", ka bërë me dije ai për KP.





# Pse “gafa” e Bidenit mund ta ndryshojë të ardhmen e Ukrainës



Gjithçka po shkonte sipas planit. Në orët e fundit, me të vërtetë dukej se ushtria ruse kishte për qëllim të përqendrohej në Donbass, duke lënë vetëm Kievin dhe pjesën tjetër të Ukrainës. Kjo, në fakt, do të kishte qenë një lloj strategjie rrugëdaljeje, e cila do t'i kishte lejuar Vladimir Putinin të dilte nga kënetat ushtarake në të cilën ishte futur. Megjithatë, gafa e fundit e Joe Bidenit mund të ketë ndryshuar situatën.

## Profecia (e saktë) e gjeneralit

Planet e cituara në fillim të artikullit ishin përshkruar në detaje nga ish gjenerali amerikan, Ben Hodges. Në një raport të përgatitur për

Qendrën për Analizën e Politikave Evropiane të datës 16 mars, Hodges shpjegonte se Kremlinin do të kishte dhjetë ditë për të fituar luftën. Pasi të jetë tejkaluar ky kufi, Moska ndoshta do të kishte përdorur një lloj plani B, për të mos dalë me turp.

Analiza e ish gjeneralit amerikan u bazua në një studim të plotë të informacionit publik të ndërthurur me të dhëna të tjera. Nga konsideratat e tij doli se rreth dhjetë ditë më parë, ushtrisë ruse po i mbaronin municionet dhe njerëzit, ndërkohë që rezistenca ukrainase po reagoonte më mirë se ç'pritej.

Analiza e Hodges rezultoi e saktë, duke qenë se më 25 mars, Zëvendës Shefi i

Shtabit të Rosisë, Sergej Rudskoi, kishte shpallur të përfunduar fazën e parë të operacionit ushtarak. Që atëherë, Moska do të fokusohet në jugun e vendit, duke iu përkushtuar çlirimit të Donbasit. Ka të ngjarë që Mariupoli, dhe ndoshta Odessa, të ishin në krye të listës së Kremlinin.

## Ndryshimi programi?

Me pak fjalë, gjithçka po shkonte siç parashikohej nga Hodges. Përveç se dalja e Joe Bidenit në Varshavë mund ta ketë komplikuar situatën duke shkatërruar mundësinë e një lloj lehtësimi të presionit ndaj Kievit dhe zonave përreth. Presidenti amerikan e ka quajtur Putinin një “kasap” dhe një “tiran që nuk mund

të qëndrojë në pushtet”, duke shkaktuar zemërimin e parashikueshëm të Moskës.

Mund të jetë një rastësi, por në 24 orët e fundit kemi parë mbi 30 bombardime të komplekseve rezidenciale dhe infrastrukturave në rajonin e Kievit. Kjo u njoftua nga vetë administrata ushtarake rajonale e Kievit në Telegram, cituar nga UNIAN. “Gjatë gjithë periudhës së luftës, shkatërrime u regjistruan në 34 nga 69 komunitetet në rajon, ose 49.2%. Në total, më shumë se 500 objektiva,” bëri të ditur administrata.

“Rusia po përpiqet të ndajë Ukrainën në dysh për të krijuar një rajon të kontrolluar nga Moska, pasi dështoi të marrë kontrollin

e të gjithë vendit”, tha në orët e fundit shefi i inteligjencës ushtarake ukrainase Kyrylo Budanov, i cituar nga The Guardian. Sipas deklaratave, “pas dështimeve pranë Kievit dhe pamundësisë së përmbyesjes së qeverisë qendrore të Ukrainës”, ka “arsye për të besuar” se Putini “po shqyrton një skenar korean për Ukrainën”, domethënë “ai do të përpiqet të për të vendosur një vijë ndarëse midis rajoneve të pushtuara dhe të papushtuara të vendit tonë, “sepse” është absolutisht i paafte për të pushtuar të gjithë vendin”. Nuk është më aq e qartë që Moska do të vendosë të fokusohet vetëm në Ukrainën jugore. / Il Giornale – Bota.al



# A mund të mësohen njerëzit të jenë optimistë?



Optimizmi është një nga mjetet më të mira për të arritur mirëqenien optimale psiko-fizike, kjo ndjenjë dhe është po aq e fuqishme sa edhe një ilaç. Të shohësh gjithmonë gotën gjysmë të mbushur, të mban të shëndetshëm, të ndihmon të jetosh më mirë, dhe është një antistres shumë efektiv.

Aq sa “psikoterapia e optimizmit” përdoret shpesh në rastet e depresionit, çrregullimeve të stresit post-traumatik, sëmundjeve të rënda, apo edhe për të kapërcyer pikëllimin nga humbja e një njeriu të dashur, si dhe në momente të tjera të vështira.

## Gjithçka nis që nga fëmijëria

Po, sepse mund të mësohemi që të jemi optimistë. Gjenetika ndikon vetëm rreth 25 për qind tek kjo prirje. Por edhe ata që kanë tashmë një pikëvështrim të zymtë për të ardhmen, mund ta ndryshojnë atë. Enriko Zanalda, president i Shoqatës Italiane të Psikiatrisë, nënvizon se një rol të madh luan fëmijëria.

“Optimizmi mësohet në familje, që në vitet e para të

jetës. Nëse prindërit kultivojnë sigurinë tek fëmijët, kjo çon në një perceptim dhe vetëdije të mirë, dhe për rrjedhojë në një marrëdhënie me të tjerët, sidomos në adoleshencë, të karakterizuar nga pozitiviteti. Dhe kjo sjell reagime të favorshme duke e rritur vetëbesimin” - thekson ai.

Dëgjimi i fëmijëve dhe të kuptuarit e emocioneve të tyre, vlerësimi i përpjekjeve të tyre pavarësisht nga rezultatet, fokusimi tek ngjarjet e bukura, janë që të gjitha këshilla të mira për t'i mësuar fëmijët që kenë një vizion optimist për gjërat. Por shpresë ka edhe për ata nuk kanë pasur prindër shumë mbështetës.

“Shkolla mund të bëjë shumë për të promovuar emocione pozitive. Por ai që nuk ka qenë asnjëherë në gjendje të mbështetet tek të tjerët për të mësuar të jetë optimist, dhe është i bllokuar në një këndvështrim negativ mbi botën, mund ta bëjnë këtë si një i rritur nëpërmjet disa ndërhyrje psikologjike specifike” - thotë Maria Kquatropani, profesore dhe psikologjisë klinike dhe drejtore shkencore e Qendrës për Kërkime dhe Ndërhyrje Psikologjike në Universitetin e Mesinës.

## Ana pozitive

Metodat e strukturuar të psikoterapisë, mund të jenë një zgjidhje për pesimistët e mëdhenj. Por të gjithë ne mund t'i stërvitim “muskujt” e optimizmit edhe në jetën e përditshme. Për shembull, duke zgjedhur të shoqërohemi me njerëz pozitivë, sepse mendimet e mira janë ngjitëse.

Më pas është e nevojshme të bëhet një përpjekje e vetëdijshme, siç shpjegon psikiatri Aparna Ajer nga Qendra Mjekësore Jugperëndimore e Universitetit të Teksasit (SHBA), që ka zhvilluar një lloj dekalogu se si mund të jemi më optimistë në jetë.

“Ka gjithmonë një mënyrë tjetër për t'i parë ngjarjet. Ajo quhet inkuadrim pozitiv. Për shembull nëse shiu ju pengon të bëni banjo dielli në tarracën e shtëpisë, pse të mos shfrytëzoni rastin për të lexuar një libër të bukur në divanin e dhomës së ndenjes? Në fillim duhet të punoni shumë për të gjetur anën pozitive të gjërave dhe situatave. Më pas kjo lloj qasje bëhet automatike” - thotë ajo. Të sillësh në këtë formë, ndryshon për mirë edhe

trurin. Riçard Dejvidson, drejtor i Laboratorit për Neuroshkencën Afektive në Universitetin e Uiskonsinit (SHBA), thotë se zgjedhja e vetëdijshme për të qenë optimist, i ndryshon qarqet e trurit dhe sjell një reagim më të mirë ndaj çdo lloj përvoje negative.

Për të trajnuar optimizmin, mund të ndihmojë edhe identifikimi i asaj që në jetën e përditshme priremi ta shohim me syrin e keq (punë, marrëdhënie, ose diçka tjetër) duke u përpjekur të kemi një qasje më pozitive. Ose ndaluni dhe reflektoni se sa negative janë mendimet tuaja, në përpjekje për të ndryshuar drejtimin e tyre. Për shembull, duke hipotetizuar se si të merrni një rezultat të mirë nga një sfidë. Dhe është gjithashtu një ushtrim i mirë i optimizmit të qenit i sjellshëm me veten dhe inkurajimi i vetes. Ose të ndjekësh një mënyrë jetese të shëndetshme, pasi të ndërjet mirë të jep një pamje më rozë mbi botën.

## Angazhim dhe trajnim

Megjithatë, ekzistojnë edhe ushtrime më të thjeshta që na ushqejnë me pozitivitet. Për shembull heqja dorë nga

leximi i lajmeve, sepse 5 minuta lajme të këqija në mëngjes, mjaftojnë për të ndikuar tek e gjithë dita në vazhdim.


Apo mbajtja e një “ditari të mirënjohjes”, në të cilin mund të shkruajmë çdo ditë diçka që na bën të ndihemi mirë, edhe nëse kjo ka qenë vetëm kafeja e mëngjesit, apo gjesti i mirë i një të panjohuri. E njëjta gjë ndodh edhe nëse nuk e humbni rastin për të qeshur, pasi e qeshura është një anti-stres i menjëhershëm.

Madje edhe nëse shkëputeni për pak kohë nga rrjetet sociale. Kur fotot e atyre që duken se bëjnë jetë të mrekullueshme, nxisin një konkurrencë jo shumë të shëndetshme tek ju, është më mirë të shkëputeni për pak kohë.

Rregulli i fundit mund të duket kundër-intuitiv, por ka të bëjë me njohjen e asaj që është negative, kur ajo ekziston: “Optimisti është realist. Kushdo që është optimist pavarësisht nga ngjarjet, është viktimë e një iluzioni dhe rrezikon të lëndohet: të luaxh bixhozi duke menduar se keni lindur nën një yll me fat, është një mënyrë e sigurt për ta shkatërruar veten” - thotë Kquatropani.



**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Enveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com




**QENDRA SPORTIVE  
 'BUJQËSIA'  
 TEL: 045/82 82 82**



## Kosova e zhvillon stërvitjen e fundit, Fazliji e vlerëson speciale miqësoren me Zvicrën



“Paraqitja kundër Burkina Fasos ka qenë shumë e mirë. Futbollistët janë në formë dhe secili prej nesh ka dëshirë e përkushtim për t’i treguar vlerat e veta para trajnerit të ri. Tash kundër Zvicrës na pret një ndeshje shumë e fortë, ku do të ketë shumë shqiptarë në stadium dhe pa dyshim do të jetë një ndeshje shumë e veçantë. Kjo ndeshje do të jetë një festë futbolli. Ne do ta japim maksimumin dhe udhëtojmë për ta fituar ndeshjen”, ka thënë Betim Fazliji

**PRISHTINË, 27 MARS** - Përfaqësuesja e Kosovës e ka zhvilluar të dielën stërvitjen e fundit para udhëtimit në Cyrih, ku të martën do ta zhvillojë miqësoren e radhës

kundër Zvicrës. Edhe në stërvitjen e së dielës futbollistët kanë stërvitur me përkushtim dhe me intensitet të plotë, teksa përzgjedhësi Alain Giresse ka

punuar në disa aspekte tekniko-taktike, duke përfshirë edhe skema të ndryshme nga ndërprerjet. Të gjithë futbollistët janë në formë të mirë dhe e presin me padurim përballjen me zvicranët, duke pasur parasysh edhe faktin se në stadium do të kenë përkrahje të madhe nga bashkatdhetarët tanë atje. Mbrojtësi i kombëtares, Betim Fazliji, i cili është njëri nga futbollistët e rritur dhe aktiv në futbollin e atjeshëm theksoi se kjo ndeshje do të

jetë speciale për të. “Paraqitja kundër Burkina Fasos ka qenë shumë e mirë. Futbollistët janë në formë dhe secili prej nesh ka dëshirë e përkushtim për t’i treguar vlerat e veta para trajnerit të ri. Tash kundër Zvicrës na pret një ndeshje shumë e fortë, ku do të ketë shumë shqiptarë në stadium dhe pa dyshim do të jetë një ndeshje shumë e veçantë. Kjo ndeshje do të jetë një festë futbolli. Ne do ta japim maksimumin dhe udhëtojmë për ta fituar ndeshjen. Jemi

disa lojtarë që jemi rritur në Zvicër dhe për mua është një ndeshje speciale dhe dua të fitojmë për t’i treguar çfarë potenciali ka Kosova dhe çfarë ekipi jemi. Për ‘Dardanët’ presim të na mbështesim edhe kundër Zvicrës, ashtu sikurse ndaj Burkina Fasos dhe t’i gëzojmë me lojë të mirë”, ka thënë Fazliji. Ekspedita e Përfaqësues së Kosovës sot (e hënë) në mëngjes udhëton në Cyrih, ku pasdite do ta zhvillojë stërvitjen e fundit para duelit me Zvicrën.

### Bruno Arrabal largohet nga Drenica

**SKENDERAJ, 27 MARS** - Klubi i futbollit, Drenica ka njoftuar se ka ndërprerë bashkëpunimin me vullnet të dyanshëm me futbollistin, Bruno Arrabal Passamani. Siç bëhet e

ditur, Passami është larguar për një rast emergjent në familje, i cili është detyruar të rikthehet në Brazil. “Klubi futbollistik ‘Drenica’, njofton se ka ndërprerë

bashkëpunimin me vullnet të dyanshëm me futbollistin, Bruno Arrabal Passamani, për shkak që ky i fundit për një rast emergjent në familje është detyruar të rikthehet në

Brazil, lojtari ka bërë kërkesë zyrtare për largim, të cilën klubi e ka mirëkuptuar dhe e ka aprovuar kërkesën e lojtarit”, thuhet në njoftimin e klubit kuqez.







## Fitore e rëndësishme për Prishtinës, Prizreni 16 mposhti kampionët e Yllit

**PRISHTINË, 27 MARS** - Sigal Prishtina ka shënuar fitore shumë të rëndësishme ndaj Bashkimit me rezultat 93:74 (16:24, 29:19, 20:19, 28:12), në xhiron e 24-t të Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll. Prizrenasit e nisën më mirë ndeshjen, me një epërsi prej shtatë pikësh, 7:14, dhe gjatë gjithë çerekut të parë ishin në epërsi, duke e fituar këtë pjesë 16:24. "Bardhekaltrit" nuk u dorëzuan dhe u rikthyen shpejt për të barazuar rezultatit në 34:34, e më pas shkuan në pushim

me rezultat 45:43. Periudha e tretë ishte e baraspeshuar, ku asnjëra skuadër nuk arrinte të shkëputej, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 65:62, duke bërë që sfida të vendoset në dhjetë minutat e fundit. E, në dhjetë minutat e fundit, prishtinasit ishin shumë më të mirë, si në mbrojtje, ashtu edhe në sulm, duke shënuar fitore bindëse 93:74. Te Sigal Prishtina u dalluan vëllezërit Zeqiri me nga 17 pikë, Muhamedali Janjeva me 17 pikë e tetë kërcime dhe Henry Dugat me 15 pikë,

dhjetë kërcime dhe tetë asistime, kurse te Bashkimi u dalluan Valon Bunjaku me 15 pikë, pesë kërcime e pesë asistime dhe John Florevus me 17 pikë e 11 kërcime. Sigal Prishtina ka 12 fitore e 12 humbje, kurse Bashkimi nëntë fitore e 15 humbje. Prizreni 16 ka shënuar fitore ndaj Golden Eagle Yllit 82:91 (23:26, 22:15, 9:26, 28:24), ndeshje që u zhvillua në Prizren, në xhiron e 24-t të Art Superligës së Kosovës në basketboll. Çereku i parë ishte pothuajse i baraspeshuar, ku për një

nuancë prizrenasit ishin më të mirë, madje kishin epërsi prej tetë pikësh, 7:15, ndërsa kjo pjesë përfundoi 23:26. Prizrenasit sërish në periudhën e dytë kishin epërsi deri në tetë pikë, 33:41, megjithatë, nga ky moment, therandasit këndellen me një seri prej 12:0, duke shkuar në pushim me shifrat 45:41. E kundërta ndodhi në periodën e tretë, ku basketbollistët prizrenas me një seri prej 0:13, kaluan në epërsi 45:54, ndërsa Gëzim Morina shënoi pikët e para për kampionët pas pesë

minutash lojë. Kjo pjesë ishte vendimtare, pasi përfundoi 9:26, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 54:67. Në dhjetë minutat e fundit, prizrenasit menaxhuan lojën dhe ruajtën epërsinë deri në fund, duke triumfuar 82:91. Te Golden Eagle Ylli u dalluan Henrik Sirko me 11 pikë, dhjetë kërcime e nëntë asistime, kurse te Prizreni 16 më i miri ishte Darell Davis me 24 pikë e nëntë kërcime. Golden Eagle Ylli ka 18 fitore e gjashtë humbje, ndërsa Prizreni 16 ka 14 fitore e 10 humbje.

## Verstappeni triumfon në Grand Prixin e Arabisë Saudite

**JEDDAH, 27 MARS** - Skuadra e Red Bull ka marrë fitoren e parë të këtij sezoni në Formula 1, dhe kjo fitore vjen në emër të kampionit në fuqi, Max Verstappen. Verstappen e nisi garën nga vendi i katërt, por arriti që të bënte mirë dhe të merre në fund vendin e parë. Charles Leclerc priu garën për pjesën më të gjatë, por e humbi vendin e parë në xhiron e 47-të, tri xhiro para fundit. Garë të mirë bëri edhe Lewis Hamilton, i cili u nis nga pozita e 15-të, dhe arriti që në një moment të ishte në pozitën e gjashtë. Por, fati

nuk ishte në anën e britanikut. Një "pit-stop" i lënë për shumë vonë, u vonua edhe më shumë pas një flamuri të verdhë, dhe anëtari i Mercedes u përjashtua nga matematikat. George Russell, piloti tjetër i Mercedes e mbylli garën në vendin e pestë. Sergio Perez, i cili garën e nisi në "Pole-position" arriti të mbyllte vetëm në pozitën e katërt. Carlos Sainz e mbylli garën në pozitën nga ku e nisi, vendin e tretë. Kjo është fitorja e parë e Verstappen, si kampion.







Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

### Kuvendi i Republikës së Kosovës, rishpall:

## K O N K U R S

### Për zgjedhjen e 1 (një) anëtar/e në Këshillin Gjqësor të Kosovës

Në pajtim me nenin 10 të Ligjit nr. 06/L -055 për Këshillin Gjqësor të Republikës Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së obligimit kushtetues dhe ligjor për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin Gjqësor të Republikës së Kosovës,

#### Kuvendi rishpall konkurs për plotësimin e pozitës:

1 (një) anëtar/e siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Amendamenti nr. 25 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës) nga radhët e gjyqtarëve.

Kandidati për anëtar në Këshillin Gjqësor të Republikës së Kosovës, duhet ti plotësoj kushtet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Këshillin Gjqësor, dhe aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Autobiografia (Curriculum vitae);
- Dëshmia së është emëruar gjyqtar me mandat të përhershëm;
- Dëshmia se ndaj ti nuk është shqiptuar ndonjë masë disiplinore;

### PROCEDURA E KONKURRIMIT

**Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 11 prill 2022, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:

Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtorja e Personelit, Zyra N-217).

#### Aplikacionet mund të merren në këto vende:

*Forma e shtypur:* në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

*Forma elektronike:* faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)  
Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.

Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

### Skupština Republike Kosovo ponovo objavljuje:

## K O N K U R S

### Za izbor 1 (jednog) člana u Sudskom Savetu Kosova

U skladu sa članom 10. Zakona br. 06/L-055 o Sudskom savetu Republike Kosovo i u cilju ispunjenja ustavne i zakonske obaveze za izbor članova Sudskog saveta Republike Kosovo,

#### Skupština ponovo objavljuje konkurs za ispunjenje pozicije:

1 (jednog) člana, definisanom članom 108. stav 6. tačka 2. Ustava Republike Kosovo (Amandman br. 25. Ustava Republike Kosovo) iz reda sudija.

Kandidat za člana Sudskog saveta Republike Kosovo, mora da ispuni uslove propisane Ustavom i Zakonom o Sudskom savetu, a uz aplikaciju sledeći prateći dokumenti moraju biti priloženi:

- Autobiografija (Curriculum vitae);
- Dokaz da je imenovan/a za sudiju sa stalnim mandatom;
- Dokaz da protiv njega/nje nije preduzeta disciplinska mera;

### PROCEDURA KONKURISANJA

**Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 11. april 2022. godine u 16.00 časova.**

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosovo, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

#### Aplikaciju možete uzeti u:

*Šampanoj formi:* na recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosovo, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u

*Elektronskoj formi:* internet-stranica Skupštine Republike Kosovo - [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana do 16.00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz zahtevana dokumenta.

Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

